



| | | | |
|---|-------------------------------------|--------------------------------|------------------------------|
| Planuar / Doretuar Punëhet/Protokolo Received/Delivered | 11- 02 2 | viti god year | |
| Organi /Njësia Org./Jedinita Org./Unit | Ud. Prot. Pr. Prot. Prot. No. | Shtimi e Filog. Appendix | Sasia Kohëzma Quantity |
| SKRIPSHICK | 696/2022 | | 1/3 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1235/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 31.12.2021 me numër A.nr.1235/2021, të parashtruar përmes Postës së Kosovës me datë 29.12.2021 me numër R 1949717, nga përfaqësuesja e autorizuar avokatja _____ për ankuesen _____ me adresë:

_____ në çështjen juridike "*Kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesë me numër A.nr.1235/2021 e datës 31.12.2021 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____, punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitë "*Infermiere*", në Drejtorin Rajonale –Divizioni i Sigurisë Publike në Gjilan/Njësia e Burimeve Njerëzore për Administratë dhe Personel në Gjilan, sipas kontratës së punës nr.referencës:07/1-01A/0310 të datës 19.08.2014, e cila ka parashtruar kërkesë me datës 26.10.2021 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme në Policinë e Kosovës, për kompensimin e pagesës së një page mujore për tri vitet e fundit (nga viti 2018,2019 dhe 2020), në vlerën ekuivalente me pagën e rregullt mujore, si dhe shujtën ditore, konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Me datë 03.11.2021 ankuesja e ka pranuar përgjigjen nga Drejtoria e Divizionit të Personelit të Policisë së Kosovës, lidhur me kërkesën e saj, duke sqaruar se në mungesë të buxhetit nuk mund të aprovohet kërkesa.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e datës 03.11.2021, ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave në Policinë e Kosovës, e cila me datë 23.12.2021 ka nxjerrë Vendimin me nr. Protokolli 03/02-1312, me të cilin është shpallur jo kompetent për shqyrtimin e ankesës së ankueses, bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin e datës 23.12.2021 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, me datës 29.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Postës së Kosovës, me numër R 1949717, e regjistruar me datë 31.12.2021 me numër protokoll 6448/21, e cila pretendon që tij bëhet kompensimi i pagesës së një page mujore për tri vitet e fundit (nga viti 2018,2019 dhe 2020), në vlerën ekuivalente me pagën e rregullt mujore, si dhe shujtën ditore konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.01.2022, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 01.02.2022 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit A.nr.1235/2021 me numër protokoll 64489/2021 e datës 31.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarfë/mbikëqyrës e datës 29.12.2021 e Postës së Kosovës me numër postar: R 1949717; Autorizimi i av. Kërkesë e datës 26.10.2021 e parashtruar tek Drejtoria e Përgjithshme në Policinë e Kosovës; Përgjigje e datës 03.11.2021; Ankesë e datës 03.11.2021, në Komisionin e ankesave në Policinë e Kosovës; Vendimi i datës 23.12.2021 i Komisionit për Ankesa me nr. protokoll 03/02-1312; Përgjigje në ankesë e datës 01.02.2022 nga Policia e Kosovës tek KPMSHCK-së; Kontratës së punës nr.referencë: 07/1-01A/0310 të datës 19.08.2014; Akt përcjellës i datës 07.08.2021; Vendim i datës 09.03.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, ***nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga sepse:***

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja ka themeluar marrëdhënie të punës në Policinë e Kosovës, në bazë të shkresave të lëndës sipas Kontratës së Punës nr. reference: 07/1-01A/0310 të datës 19.08.2014, e cila mbanë pozitën e punës „Infermiere”, në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Gjilan, në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës si dhe Ligjin Nr.03/ L-0212 të Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar fushën e zbatimit të ligjit që rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë, gjegjësisht dispozitat ligjore të nenit 2 paragrafin 3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: '' 3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejtë për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike''.

në rastin konkret është konstatuar se kjo pozitë hynë në kategorinë e pozitive të **nëpunësve të shërbimit publik**, dhe se ankuesja nuk e ka statusin e nëpunëses civile, për t'ju shqyrtuar ankesa në



Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën e vërteton dhe përshkrimi i detyrave të punës të pozitës "Infermiere".

Ndërlidhur me këtë pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit publik, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"***.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1235/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtarë e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses se ankueses Avokatës znj.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

